FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.21 **Datë 21 mars 2006**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9480 datë 16.2.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit të protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit"…….	
Vendim i KM nr.146, datë 8.3.2006	Për mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore hotel "Dajti" dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së hotelit…….	658
Vendim i KM nr.151, datë 15.3.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.212, datë 7.4.2005 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti i ristrukturimit të aeroportit "Nënë Tereza" sh.a."…….	666
Vendim i KM nr.152, datë 15.3.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Frakull të qarkut të Fierit……...……	666
Vendim i KM nr.153, datë 15.3.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Ura Vajgurore të qarkut të Beratit……	667
Vendim i KM nr.154, datë 15.3.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Libohovë të qarkut të Gjirokastrës……..	669
Vendim i KM nr.155, datë 15.3.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës……	670

Vendim i KM nr.156, datë 15.3.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justiniani I"…….	671
Vendim i GJK nr.5, datë 20.3.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.738, datë 28.4.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues…….	671

L I G J
Nr.9480, datë 16.2.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KOPENHAGENIT TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT "PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Kopenhagenit të Protokollit të Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4802, datë 10.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT

Marrë nga aneksi III i raportit të takimit të katërt të palëve të protokollit të Montrealit për substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit

AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT
PËR SUBSTANCAT OZON HOLLUESE

Neni 1
Amendament

A. Neni 1, paragrafi 4
Në paragrafin 4 të nenit 1 të protokollit fjalët:
Ose në aneksin B do të zëvendësohet me aneksin B, aneksin C ose aneksin E;

B. Neni 1, paragrafi 9
Paragrafi 9 i nenit 1 të protokollit do të fshihet;

C. Neni 2, paragrafi 5
Në paragrafin 5 të nenit 2 të protokollit pas fjalëve:
Nenet 2A deri 2E do të shtohet dhe neni 2H;

D. Neni 2, paragrafi 5
Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit 5 të nenit 2 të protokollit:
5bis. Çdo palë që nuk vepron nën paragrafin 1 të nenit 5 mundet, për një ose më shumë periudha kontrolli, të transferojë te një palë tjetër çdo sasi të nivelit të përllogaritur të konsumit të

dhënë në nenin 2F, në rastet kur niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit A të palës që transferon porcionin e nivelit të përllogaritur të konsumit nuk e kalon 0.25 kilogram për frymë në 1989, dhe kur totali i niveleve të përllogaritura i konsumit të palëve të interesuara nuk i kalon limitet e konsumit të dhëna në nenin 2F.

Transferta të tilla të konsumit do të njoftohen në sekretariat prej secilës nga palët e interesuara, duke dhënë termat e transferimeve të tilla dhe periudhën për të cilën do të aplikohet;

E. Neni 2, paragrafët 8 (a) dhe 11

Në paragrafët 8 (a) dhe 11 të nenit 2 të protokollit fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen sa herë që përdoren me nenet 2A deri 2H;

F. Neni 2, paragrafi 9 (a) (i)

Në paragrafin 9 (a) (i) të nenit 2 të protokollit fjalët:

dhe/ose aneksi B do të zëvendësohen me aneksi B, aneksi C dhe/ose aneksi E;

G. Neni 2F Hidrofluroklorokarbonet

Neni i mëposhtëm do të futet pas nenit 2E të protokollit:

Neni 2F: Hidrofluoroklorokarbonet

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore që fillon në 1 janar 1996 dhe në çdo periudhë 12- mujore të mëpasme, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalojnë, në vit, shumën e:

a) tri pikë një për qind të nivelit të konsumit të përllogaritur të vitit 1989 të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit A;

b) nivelin e përllogaritur të konsumit të 1989 të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C.

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëvjeçare, duke filluar nga 1 janari 2004, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasardhëse, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk i kalon gjashtëdhjetë e pesë për qind të shumës së referuar në paragrafin 1 të këtij neni, në vit.

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 2010, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëvjeçare pasuese, niveli i përllogaritur i nivelit të konsumit të substancave në kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalon tridhjetë e pesë për qind të shumës së referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëvjeçare duke filluar nga 1 janari 2015, dhe në çdo periudhë pasuese dymbëdhjetëmujore, niveli i përllogaritur i substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalon dhjetë për qind në vit të shumës së referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 2020, dhe në çdo periudhë pasuese dymbëdhjetëmujore, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalon zero pikë pesë për qind në vit të shumës së referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 2030, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalon zeron.

Që nga 1 janari 1996, çdo palë do të përpiqet që të sigurojë që:

a) Përdorimi i substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C është limitizuar në ato aplikime ku substanca të tjera ose teknologji që janë më të përshtatshme për mjedisin nuk janë të mundura;

b) Përdorimi i substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk është jashtë zonës së aplikimit që aktualisht përdoret për substancat e kontrolluara në anekset A, B dhe C, përveç në raste të veçanta për mbrojtjen e jetës ose të shëndetit njerëzor;

c) Substancat e kontrolluara në grupin I të aneksit C janë përzgjedhur për përdorim në një mënyrë që minimizon varfërimin e ozonit, duke përmbushur edhe konsideratat e tjera mjedisore të sigurisë dhe ekonomike.

H. Neni 2G: Hidrobromofluorokarbonet

Neni i mëposhtëm do të futet pas nenit 2F të protokollit:

Neni 2G: Hidrobromofluorokarbonet

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 1996, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin II të aneksit C nuk e kalon zeron. Çdo palë që prodhon substancat duhet, për të njëjtat periudha, të sigurojë që niveli i përllogaritur i prodhimit të substancave nuk e kalon zeron. Ky paragraf do të aplikohet kur palët vendosin të lejojnë nivelin e prodhimit të konsumit që është i nevojshëm të kënaqë përdorimet për të cilat është rënë dakord që janë themelore;

I. Neni 2H: Metil Bromide (Bromuri i Metilit)

Neni i mëposhtëm do të futet mbas nenit 2G të protokollit:

Neni 2H: Metil Bromide (Bromuri i Metilit)

Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 1995, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore të mëpasme, niveli i përllogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në aneksin E nuk e kalon nivelin e përllogaritur vjetor të konsumit në 1991. Çdo palë që prodhon substancën duhet, për të njëjtën periudhë, të sigurojë që niveli i përllogaritur i prodhimit të substancës, në vit, të mos e kalojë nivelin e përllogaritur të prodhimit të substancës në 1991. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqë kërkesat bazë vendore, palët që veprojnë në paragrafin 1 të nenit 5, niveli i përllogaritur i prodhimit mund ta kalojë atë limit deri me dhjetë për qind të nivelit të përllogaritur të prodhimit të 1991. Nivelet e përllogaritura të prodhimit dhe të konsumit, sipas këtij neni, nuk do të përfshijnë sasitë e përdorura nga palët për karantinë dhe aplikime paradërgimore;

J. Neni 3

Në nenin 3 të protokollit, fjalët:

2A deri 2E do të zëvendësohen me 2A deri 2H dhe fjalët ose aneksi B do të zëvendësohen sa herë që përdoren me aneksi B, aneksi C ose aneksi E;

K. Neni 4, paragrafi 1 ter

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 1 bis të nenit 4 të protokollit:

1 ter. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e të gjitha substancave të kontrolluara në grupin II të aneksit C prej çdo shteti që nuk është palë në këtë protokoll;

L. Neni 4, paragrafi 2 ter

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 2 bis të nenit 4 të protokollit:

2 ter. Duke filluar që nga një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë eksportin e të gjitha substancave të kontrolluara në grupin II të aneksit C në çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll;

M. Neni 4, paragrafi 3 ter

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 3 bis të nenit 4 të protokollit:

3 ter. Brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, palët duhet, duke ndjekur procedurën në nenin 10 të Konventës, të sqarojnë në një aneks një listë të produkteve që përmbajnë substanca të kontrolluara në grupin II të aneksit C. Palët që nuk kanë pasur kundërshtime për aneksin, në përputhje me këto procedura, do të ndalojnë, brenda një viti të hyrjes në fuqi të aneksit, importin e këtyre produkteve nga çdo shtet që nuk është palë e këtij protokolli;

N. Neni 4, paragrafi 4 ter

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 4 bis të nenit 4 të protokollit:

4 ter. Brenda pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, palët duhet të vendosin fizibilitetin e ndalimit ose kufizimit, nga shtetet jo palë në këtë protokoll, importin e produkteve të prodhuara me, por që nuk përmbajnë, substanca të kontrolluara në grupin II të aneksit C. Në qoftë se vendoset e mundshme, palët do të, duke ndjekur procedurat e nenit 10 të Konventës, të sqarojnë në një

aneks një listë të këtyre produkteve. Palët që nuk kanë pasur objeksione për aneksin në përputhje me këto procedura do të ndalojnë ose kufizojnë, brenda një viti të hyrjes në fuqi të aneksit, importimin e këtyre produkteve nga çdo shtet që nuk është palë e këtij protokolli;

O. Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të protokollit, fjalët:

substancat e kontrolluara do të zëvendësohen me substancat e kontrolluara në anekset A dhe B dhe grupi II i aneksit C;

P. Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 4 të protokollit, fjalët:

Referuar në paragrafët 1, 1 bis, 3, 3 bis, 4 dhe 4 bis dhe eksportet e referuara në paragrafët 2 dhe 2 bis do të zëvendësohen me dhe eksportet e referuara në paragrafët 1 deri 4 ter të këtij neni, dhe mbas fjalëve:

Nenet 2A deri 2E do të shtohet neni 2G;

Q. Neni 4, paragrafi 10

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 9 të nenit 4 të protokollit:

10. Nga 1 janari 1996, palët do të marrin në konsideratë nëse do ta amendojnë këtë protokoll, në mënyrë që të përfshijnë në këtë nen masat për të treguar substancat e kontrolluara në grupin I të aneksit C dhe në aneksin E me shtetet që nuk janë palë të këtij protokolli;

R. Neni 5, paragrafi 1

Fjalët e mëposhtme do të shtohen në fund të paragrafit 1 të nenit 5 të protokollit:

po të merret parasysh që çdo amendim tjetër që do t'i bëhet rregullimeve apo amendimit të adoptuar në takimin e dytë të palëve në Londër, më 29 qershor 1990, do të aplikohet për palët që veprojnë nën këtë paragraf pasi rishikimi i dhënë në paragrafin 8 të këtij neni ka ndodhur dhe do të bazohet në konkluzionet e atij rishikimi;

S. Neni 5, paragrafi 1 bis

Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit 1 të nenit 5 të protokollit:

1bis. Palët, duke marrë në konsideratë rishikimin e referuar në paragrafin 8 të këtij neni, vlerësimin e bërë sipas nenit 6 dhe çdo informacion tjetër relevant, do të vendosin deri në 1 janar 1996, nëpërmjet procedurës së dhënë në paragrafin 9 të nenit 2:

a) Duke respektuar paragrafët 1 deri 6 të nenit 2F, cili vit bazë, nivelet fillestare, axhendat e kontrolleve dhe datën e përfundimit për konsumin e substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C do të aplikojnë për palët që veprojnë nën paragrafin 1 të këtij neni;

b) Duke respektuar nenin 2G, për datën e përfundimit të prodhimit dhe konsumin e substancave të kontrolluara në grupin II të aneksit C do të aplikojnë për palët që veprojnë nën paragrafin 1 të këtij neni;

c) Duke respektuar nenin 2H, cili vit bazë, nivelet fillestare dhe axhenda e kontrollit për konsumin dhe prodhimin e substancës së kontrolluar në aneksin E do të aplikohet për palët që veprojnë nën paragrafin 1 të këtij neni;

T. Neni 5, paragrafi 4

Në paragrafin 4 të nenit 5 të këtij protokolli, fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2H;

U. Neni 5, paragrafi 5

Në paragrafin 5 të nenit 5 të këtij protokolli, pas fjalëve:

dhënë në nenin 2A deri 2E do të shtohet dhe çdo masë kontrolli në nenet 2F deri 2H që është vendosur sipas paragrafit 1bis të këtij neni;

V. Neni 5, paragrafi 6

Në paragrafin 6 të nenit 5 të protokollit, pas fjalëve:

detyrime të dhëna në nenet 2A deri 2E do të shtohet ose të gjitha detyrimet në nenet 2F deri 2H që janë vendosur sipas paragrafit 1 bis të këtij neni;

W. Neni 6

Fjalët e mëposhtme do të fshihen nga neni 6 i protokollit:

Nenet 2A deri 2E dhe situata për sa i përket prodhimit, importit dhe eksportit të substancave tranzicionale në grupin I të aneksit C dhe të zëvendësohen nga nenet 2A deri 2H;

X. Neni 7, paragrafët 2 dhe 3

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të protokollit do të zëvendësohen nga paragrafët e mëposhtëm:

2. Çdo palë do t'i japë sekretariatit të dhëna statistikore mbi prodhimin, importimin dhe eksportimin e secilës nga substancat e kontrolluara:

- në anekset B dhe C, për vitin 1989,
- në aneksin E, për vitin 1991,

ose vlerësimet më të mira të mundshme të këtyre të dhënave kur të tilla të dhëna nuk janë të gatshme, jo më vonë se tre muaj pas datës në të cilën dispozitat ligjore të dhëna në protokoll për sa i përket substancave në anekset B, C dhe E hyjnë respektivisht në fuqi për atë palë.

3. Çdo palë do t'i japë sekretariatit të dhëna statistikore për prodhimin vjetor (siç është dhënë në paragrafin 5 të nenit 1) për secilën prej substancave të listuara në anekset A, B, C dhe E dhe në mënyrë të veçantë, për çdo substancë:

- sasitë e përdorura për bazë ushqimore,
- sasitë e shkatërruara nga teknologjitë e aprovuara nga palët,
- importet dhe eksportet e palëve dhe jo palëve respektivisht,

për vitin, gjatë të cilit dispozitat që kanë të bëjnë me substancat në anekset A, B, C dhe E hyjnë respektivisht në fuqi për atë palë dhe për çdo vit të mëpasëm. Të dhënat do të dërgohen jo më vonë se nëntë muaj nga fundi i vitit për të cilin janë këto të dhëna;

Y. Neni 7, paragrafi 3 bis

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 3 të nenit 7 të protokollit:

3 bis. Çdo palë do t'i sigurojë sekretariatit të dhëna statistikore të veçanta vjetore për importet dhe eksportet vjetore të çdo substance të kontrolluar të listuar në grupin II të aneksit A dhe grupit I të aneksit C që janë ricikluar;

Z. Neni 7, paragrafi 4

Në paragrafin 4 të nenit 7 të protokollit fjalët:

në paragrafët 1, 2 dhe 3 do të zëvendësohen me në paragrafët 1, 2, 3 dhe 3 bis;

A A. Neni 9, paragrafi 1 (a)

Fjalët e mëposhtme do të fshihen nga paragrafi 1 (a) i nenit 9 të protokollit;

dhe BB transitore

Neni 10, paragrafi 1

Në paragrafin 1 të nenit 10 të protokollit, pas fjalëve:

Nenet 2A deri 2E do të shtohet dhe çdo masë kontrolli në nenet 2F deri 2H që janë vendosur sipas paragrafit 1bis të nenit 5;

CC. Neni 11, paragrafi 4 (g)

Fjalët e mëposhtme do të fshihen nga paragrafi 4 (g) i nenit II të protokollit:

dhe gjendja për sa u përket substancave transitore;

DD. Neni 17

Në nenin 17 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2H;

EE. Anekset
1. Aneksi C
Aneksi i mëposhtëm do të zëvendësojë aneksin C të protokollit:
Aneksi C – Substancat e kontrolluara

Grupi Substanca Numri i izomereve Potenciali* i varfërimit të ozonit

Grupi I

CHFCI2 (HCFC-21) ** 10.04
CHF2CI (HCFC-22) ** 10.055
CH2FCI (HCFC-31) 10.02
C2HFCI4 (HCFC-121) 20.01-0.04
C2HF2CI3 (HCFC-122) 30.02-0.08
C2HF3CI2 (HCFC-123) 30.02-0.06
CHCI2CF3 (HCFC-123) ** - 0.02
C2HF4CI (HCFC-124) 20.02-0.04
CHFCICF3 (HCFC-124) ** - 0.022
C2H2FCI3 (HCFC-131) 30.007-0.05
C2H2F2CI2 (HCFC-132) 40.008-0.05
C2H2F3CI (HCFC-133) 30.02-0.06
C2H3FCI2 (HCFC-141) 30.005-0.07
CH3CFCI2 (HCFC-141b) ** - 0.11
C2H3F2CI (HCFC-142) 30.008-0.07
CH3CF2CI (HCFC-142b)**- 0.065
C2H4FCI (HCFC-151) 20.003-0.005
C3HFCI6 (HCFC -221) 50.015-0.07
C3HF2CI5 (HCFC-222) 90.01-0.09
C3HF3CI4 (HCFC-223) 120.01-0.08
C3HF4CI3 (HCFC-224) 120.01-0.09
C3HF5CI2 (HCFC-225) 90.02-0.07
CF3CF2CHCI2 (HCFC -225ca) ** - 0.025
CF2CICF2CHCIF (HCFC-225 cb) ** -0.033
C3HF6CI (HCFC – 226) 50.02-0.10
C3H2FCI5 (HCFC-231) 90.05-0.09
C3H2F2CI4 (HCFC-232) 160.008-0.10
C3H2F3CI3 (HCFC-233) 180.007-0.23
C3H2F4CI2 (HCFC-234) 160.01-0.28
C3H2F5CI (HCFC-235) 90.03-0.52
C3H3FCI4 (HCFC-241) 120.004-0.09
C3H3F2CI3 (HCFC-242) 180.005-0.13
C3H3F3CI2 (HCFC-243) 180.007-0.12
C3H3F4CI (HCFC-244) 120.009-0.14
C3H4FCI3 (HCFC-251) 120.001-0.01
C3H4F2CI2 (HCFC-252)160.005-0.04
C3H4F3CI (HCFC-253) 120.003-0.03
C3H5FCI2 (HCFC-261) 90.002-0.02
C3H5F2CI (HCFC-262) 90.002-0.02
C3H6FCI (HCFC-271) 50.001-0.03

GRUPI II

CHFBr 211.00
CHF2Br (HBFC-22B1) 10.74

CH2FBr 10.73
C2HFBr 420.3-0.8
C2HF2Br 330.5-1.8
C2HF3Br 230.4-1.6
C2HF4Br 20.7-1.2
C2H2FBr 330.1-1.1
C2H2F2Br 240.2-1.5
C2H2F3Br 30.7-1.6
C2H3FBr 230.1-1.7
C2H3F2Br 30.2-1.1
C2H4FBr 20.07-0.1
C3HFBr 650.3-1.5
C3HF2Br 590.2-1.9
C3HF3Br 4120.3-1.8
C3HF4Br 3120.5-2.2
C3HF5Br 290.9-2.0
C3HF6Br 50.7-3.3
C3H2FBr 590.1-1.9
C3H2F2Br 4160.2-2.1
C3H2F3Br 3180.2-5.6
C3H2F4Br 2160.3-7.5
C3H2F5Br 80.9-14
C3H3FBr 4120.08-1.9
C3H3F2Br 3180.1-3.1
C3H3F3Br 2180.1-2.5
C3H3F4Br 120.3-4.4
C3H4FBr 3120.03-0.3
C3H4F2Br 2160.1-1.0
C3H4F3Br 120.07-0.8
C3H5FBr 290.04-0.4
C3H5F2Br 90.07-0.8
C3H6FBr 50.02-0.7

* Aty ku tregohet një grup ODP, vlera më e lartë në atë grup do të përdoret për qëllimet e protokollit. ODP-të e listuara si vlera të vetme janë vendosur nga përllogaritjet e bazuara në matjet laboratorike. Ato të listuara si një grup janë bazuar në përafërsi dhe janë më pak të sakta. Grupi I i përket një grupi izomerik. Vlera më e lartë është vlerësimi i përafërt i ODP-së me ODP më të lartë dhe vlera më e ulët është vlerësimi i përafërt i ODP-së së izomerit me ODP më të ulët.

** Identifikon substancat më të përdorura komercialisht me vlera ODP të listuara për to për t'u përdorur për çështje të protokollit.

2. Aneksi E
Aneksi i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit.
Aneksi E – Substanca të kontrolluara

Grupi	Substanca	Potenciali ozon varfërues
		Grupi I
CH3Br	bromuri i metilit	0.7

Neni 2
Marrëdhënia me amendamentin e vitit 1990

Asnjë shtet ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi për këtë amendament pa depozituar më parë ose në të njëjtën kohë një instrument të tillë për amendamentin e miratuar në takimin e dytë të palëve në Londër, më 29 qershor 1990.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky amendament do të hyjë në fuqi më 1 janar 1994, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose aderimi për të janë depozituar nga shtetet ose organizatat rajonale për integrim ekonomik që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat ozon holluese. Në rast se ky kusht nuk është përmbushur deri në këtë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë që pason datën në të cilën është plotësuar.

Për qëllimet e paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik nuk do të numërohet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, siç është dhënë në paragrafin 1, ai do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër të protokollit në ditën e nëntëdhjetë të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

VENDIM
Nr.146, datë 8.3.2006

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE TË NDËRMARRJES SHTETËRORE HOTEL "DAJTI" DHE NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NDËRTESËS SË HOTELIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006" dhe të shkronjës "c" të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes shtetërore hotel "Dajti", në varësi administrative të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Punonjësit e ndërmarrjes shtetërore hotel "Dajti", që dalin të papunë nga mbyllja e veprimtarisë ekonomiko-financiare të kësaj ndërmarrjeje, përfitojnë të drejtën e pagesës, për pagën bruto, për dy vjet në rast se kanë mbi tre vjet vjetërsi pune, dhe për një vit nëse kanë më pak se tre vjet vjetërsi pune duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Enti i Turizmit, si institucion buxhetor në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të bëjë likuidimin e shumave të pagesave përkatëse, në bazë të listëpagesave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Periudha gjatë së cilës këta persona do të marrin pagesën e përcaktuar në këtë vendim, të njihet periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, punonjësit t'i nënshtrohen trajtimit me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Detyrimet kontabile, që ndërmarrja ka ndaj të tretëve deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, në shumën 73 529 000 (shtatëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë, sipas aneksit nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Detyrimet kontabile kreditore, që të tretët kanë ndaj ndërmarrjes deri në çastin e mbylljes së veprimtarisë, në shumën 12 845 000 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë) lekë, sipas aneksit nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të ndiqen për t'u arkëtuar nga Enti i Turizmit. Fondet e arkëtuara të derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

7. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, në titullin 085 "Enti i turizmit", nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, t'i shtohet fondi prej 116 405 634 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga i cili:

- 42 876 644 (dyzet e dy milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë në zërin "Paga e sigurimeve shoqërore" për pagesën e punonjësve.

- 73 529 000 (shtatëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë) lekë në zërin "Shpenzime operative" për mbulimin e detyrimeve ndaj të tretëve.

8. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së ndërmarrjes shtetërore hotel "Dajti", nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve te Ministria e Punëve të Jashtme, për t'u përdorur si seli për këtë Ministri.

9. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, në përputhje me vendimin nr.153, datë 3.4.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", të bëjë transferimin e kapitaleve të patrupëzuara dhe inventarin ekonomik e të mjeteve të xhiros të kësaj ndërmarrjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Financave, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

DETYRIMET E NDËRMARRJES HOTEL "DAJTI" NDAJ TË TRETËVE

KESH	18 816 000 lekë
Sigurime shoqërore	26 724 000 lekë
Ujësjellësi	9 923 000 lekë
Albetelecom	4 102 000 lekë
Taksa të pushtetit vendor	11 957 000 lekë
Genc Reci	965 275 lekë
Nikolla Qirko	41 950 lekë
Idriz Celo	117 810 lekë
Firma "Patrik klim"	195 000 lekë
Dega e karburantit "Albpetrol"	464 000 lekë
Firma "Dado"	77 500 lekë
Sanie Tafa	120 000 lekë

Sokrat Bozo	5 925 lekë
Firma duble (Florian Ciko)	20 000 lekë
Shuma	**73 529 000 lekë**

ANEKSI NR.2
DETYRIMET QË TË TRETË KANË NDAJ NDËRMARRJES HOTEL “DAJTI”

Nga qiratë	Gjithsej
Taverna Dajti	9 760 000 lekë
Programi Phare	683 000 lekë
Agjencia Jat	210 000 lekë
Shoqata e të përndjekurve politikë	100 000 lekë
	10 753 000 lekë
Debitorë nga aktivitetet	
Partia Socialiste	48 000 lekë
Ministria e Kulturës	840 000 lekë
Federata e volejbollit	234 000 lekë
Teatri Kombëtar	516 000 lekë
Ministria e Arsimit	35 000 lekë
Ministria e Turizmit	214 000 lekë
Akademia e Shkencave	32 000 lekë
Tetri i Operas	32 000 lekë
Shkolla e Magjistraturës	39 000 lekë
Qendra bamirëse “Memaliaj”	102 000 lekë
	2 092 000 lekë

Gjithsej detyrimet që i kanë të tretët kësaj ndërmarrjeje janë në shumën 12 845 000 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
NDËRMARRJA HOTEL "DAJTI"

TABELA E EFEKTEVE FINANCIARE PËR PAGA+SIG.SHOQËRORE
PERIUDHA 2-VJEÇARE

Nr	Emri mbiemri	Vj. në "Dajti"	Pag. mujore	Pag. vjetore	Pag. 2-vjeçare	Sig. shoq	Sig 1-vjeçar	Sig 2-vjeçar	Totali sig+pag
			1	2=1x12 muaj	3=2x2 vjet	4	(30.794x12 muaj)	5=4x 24 muaj	6=3+5
	Prokop Zoraqi	3	65000	78 000	1560000	19209		451016	2021016
1	Elderina Bardhi (Ndoja)	6	52000	624 000	1248000	15964		383136	1631136
2	Nexhmie Shehu	2	25000	300000		7675	92100		392100
3	Florand Perolla	3	18000	216000	432000	5526		132624	564624
4	Hyrie Daja	3	52000	624000	1248000	15964		383136	1631136
5	Suzana Kote	36	25000	300000	600000	7675		184200	784200
6	Elisabeta Balilaj	23	22000	264000	528000	6754		162096	690096
7	Asije Jaupaj	6	20000	240000	480000	6140		147360	627360
8	Diana Teneqexhi	18	14000	168000	336000	4298		103152	439152
9	Shpresa Toto	16	14000	168000	336000	4298		103152	439152
10	Enver Ramobanaj	15	20000	240000	480000	6140		147360	627360
11	Selim Ballabani	6	18000	216000	432000	5526		132624	564624
12	Marjana Meci	7	25000	300000	600000	7675		184200	784200
13	Shpresa Zylfo	13	14000	168000	336000	4298		103152	439152
14	Majlinda Lakra	18	14000	168000	336000	4298		103152	439152
15	Artan Reci	17	14000	168000	336000	4298		103152	439152
16	Bruno Marku	13	14000	168000	336000	4298		103152	439152
17	Donika Qefalia	12	12514	150168	300336	3842		92203	392539
18	Drita Oshafi	12	12514	150168	300336	3842		92203	392539
19	Manushaqe Shaba	17	12514	150168	300336	3842		92203	392539
20	Manushaqe Dule	7	12514	150168	300336	3842		92203	392539
21	Fatbardha Hoxha	12	12514	150168	300336	3842		92203	392539
22	Ariana Qordja	18	21000	252 000	504000	6447		154728	658728
23	Emine Haxhillari	27	12514	150168	300336	3842		92203	392539
24	Fatmira Xhepaxhi	36	12514	150168	300336	3842		92203	392539
25	Myzejen Reka	6	12514	150168	300336	3842		92203	392539

26	Violeta Gjurgjaj (Gjergji)	23	12514	150168	300336	3842		92203	392539
27	Merita Tresa	17	12514	150168	300336	3842		92203	392539
28	Vera Ibrahimi	17	12514	150168	300336	3842		92203	392539
29	Hava Koci	24	15000	180000	360000	4605		110520	470520
30	Qerime Balla	19	12514	150168	300336	3842		92203	392539
31	Lavdie Cipi	35	12514	150168	300336	3842		92203	392539
33	Krenar Mema	15	52000	624000	1248000	15964		383136	1631136
34	Besnik Mema	20	32000	384000	768000	9824		235776	1003776
35	Deliko Bellani	33	18000	216000	4320000	5526		132624	564624
36	Hava Hajderllliu	32	18000	216000	4320000	5526		132624	564624
37	Sanie Cuka	30	18000	216000	4320000	5526		132624	564624
38	Tatjana Bushi (Ndini)	32	15000	180000	36000	4605		110520	470520
39	Leme Kaloshi	3	12514	150168	300336	3842		92203	392539
40	Liljana Allushi	26	13000	156000	312000	3991		9574	407784
41	Dhimitraq Kote	40	28000	336000	672000	8596		206304	878304
42	Skënder Topi	33	13000	216000	432000	5526		132624	564624
43	Fatos Bajo	33	17000	204000	408000	5219		125256	533256
44	Flamur Baci	15	12514	150168	300336	3842		92203	392539
45	Vjollca Rodi	27	15000	180000	36000	4605		110520	470520
46	Kostandina Mece	26	13000	156000	312000	3991		95784	407784
47	Ilda Nikolla	17	13000	156000	312000	3991		95784	407784
48	Irena Qori	20	12514	150168	300336	3842		92203	392539
49	Roland Lako	8	13000	156000	312000	3991		95784	407784
50	Marcela Hyka	27	12514	150168	300336	3842		92203	392539
51	Alie Mazi	8	12514	150168	300336	3842		92203	392539
52	Jashar Alimeri	17	20000	240000	480000	6140		147360	627360
52	Gëzim Ajazi	6	12514	150168	300336	3842		92203	392539
54	Dhurata Kuqi	23	13000	156000	312000	3991		95784	407784
55	Semiha Sorra	32	15000	180000	360000	4605		110520	470520
56	Fatma Çashku	19	12514	150168	300336	3842		92203	392539
57	Meliha Vogli	18	12514	150168	300336	3842		92203	392539
58	Pjetër Nika	4	52000	624000	128000	15964		383136	1631136
59	Pirro Bucka	14	12514	150168	300336	3842		92203	392539
60	Fatmir Brari	3	12514	150168	300336	3842		92203	392539
61	Musa Balla	3	12514	150168	300336	3842		92203	392539
62	Edvan Goxhamani	3	12514	150168	300336	3842		92203	392539

63	Hasan Kazasi	13	12514	150168	300336	3842		92203	392539
64	Arjan Pulaj	8	12514	150168	300336	3842		92203	392539
65	Edmond Xhediku	15	13 000	156000	312000	3991		95784	407784
66	Qemal Jella	14	12514	150168	300336	3842		92203	392539
67	Ismet Sula	5	12514	150168	300336	3842		92203	392539
68	Feim Aliaj	16	12514	150168	300336	3842		92203	392539
69	Bujar Mema	8	12514	150168	300336	3842		92203	392539
70	Kujtim Shefqeti	13	20 000	240000	480000	6140		147360	627360
71	Ylli Meta	6	18 000	216000	432000	5526		132624	564624
72	Besim Durishti	23	20 000	240000	480000	6140		147360	627360
73	Sabri Zylfo	15	18 000	216000	432000	5526		132624	564624
74	Nevruz Uku	17	12514	150168	300336	3842		92203	392539
75	Besnik Katroshi	39	12514	150168	300336	3842		92203	392539
76	Gëzim Gazheli	10	13 000	156000	312000	3991		95784	407784
77	Vladimir Pinderi	24	20 000	240000	480000	6140		147360	627360
	Shuma		1379962	16559544	32519088	422902	92100	9965456	42876644

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA HOTEL “DAJTI”
TIRANË

Lënda: Të dhënat financiare për trajtimin e punonjësve të ndërmarrjes hotel “Dajti”

Drejtorisë Juridike
MTKRS

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e efekteve financiare për trajtimin e punonjësve që do të dalin të papunë nga mbyllja e ndërmarrjes hotel “Dajti”

1	Paga	Sigurime shoqërore	Vjet në punë
	32819088 lekë	10057556	10854743 lekë
2	totali	53731387	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA HOTEL “DAJTI”

Lënda: Të dhënat financiare për trajtimin e punonjësve të ndërmarrjes hotel Dajti që kanë më pak se tre vjet pune në hotel “Dajti”

Emri mbiemri	Vjet në punë	Paga bruto	Paga vjetore	Sigurime shoqërore	Sigurimi vjetor
Nexhmie Shehu	2 vjet	25 000	300 000	7675	92100
Totali		392 100			

Emri	Mbiemri	Paga mujore	Pag.15-ditore	Vjetërsia në “Dajti”	Pagë x vjetërsi
Prokop	Zoraqi	65000	32 500	3	97500
Elderina	Bardhi	52000	26 000	6	156000
Nexhmije	Shehu	25000	12500	2	25000
Florand	Perolla	18000	9000	3	27000
Hyrie	Daja	52000	26 000	3	78000
Suzana	Kote	25000	12500	36	450000
Elisabeta	Balilaj	22000	11000	23	253000
Asije	Jaupaj	20000	10 000	6	60000
Diana	Teneqexhi	14000	7000	18	126000
Shpresa	Toto	14000	7000	16	112000
Enver	Ramobanaj	20000	10 000	15	150000
Selim	Ballabani	18000	9000	6	54000
Marjana	Meci	25000	12500	7	87500
Shpresa	Zylfo	14000	7000	13	91000
Majlinda	Lakra	14000	7000	18	126000
Artan	Reci	14000	7000	17	119000
Bruno	Marku	14000	7000	13	91000
Donika	Qefalia	12514	6257	12	75084
Drita	Oshafi	12514	6257	12	75084
Manushaqe	Shaba	12514	6257	17	106369
Manushaqe	Dule	12514	6257	7	43799
Fatbardha	Hoxha	12514	6257	12	75084

Ariana	Qordia	21 000	10500	18	189000
Emine	Haxhillari	12514	6257	27	168929
Fatmira	Xhepaxhia	12514	6257	36	225252
Myzejen	Reka	12514	6257	6	37542
Violeta	Gjurgjaj (Gjergji)	12514	6257	23	143911
Merita	Tresa	12514	6257	17	106369
Vera	Ibrahimi	12514	6257	17	106369
Hava	Koci	15000	7500	24	180000
Qerime	Balla	12514	6257	19	118883
Lavdie	Cipi	12514	6257	35	218995
Krenar	Mema	52000	26000	15	390000
Besnik	Mema	32000	16000	20	320000
Deliko	Bellani	18000	9000	33	297000
Hava	Hajderlliu	18000	9000	32	288000
Sanie	Cuka	18000	9000	30	270000
Tatjana	Bushi	15000	7500	32	240000
Leme	Kaloshi	12514	6257	3	18771
Liljana	Allushi	13 000	6500	26	169000
Dhimitraq	Kote	28 000	14000	40	560000
Skënder	Topi	18 000	9000	33	297000
Fatos	Bajo	17 000	8500	33	280500
Flamur	Baci	12514	6257	15	93855
Vjollca	Rodi	15000	7500	27	202500
Kostandina	Meci	13000	6500	26	169000
Ilda	Nikolla	13000	6500	17	110500
Irena	Qorri	12514	6257	20	125140
Roland	Lako	13000	6500	8	52000
Marcela	Hyka	12514	6257	27	168939
Alie	Mazi	12514	6257	8	50056
Jashar	Alimeri	20000	10000	17	170 000
Gëzim	Ajazi	12514	6257	6	37542
Dhurata	Kuqi	13000	6500	23	149500
Semiha	Sorra	15000	7500	32	240000
Fatma	Çashku	12514	6257	19	118883
Meliha	Vogli	12514	6257	18	112626
Pjetër	Nika	52000	26000	4	104000
Pirro	Bucka	12514	6257	14	87598
Fatmir	Brari	12514	6257	3	18771
Musa	Balla	12514	6257	3	18771
Edvan	Goxhamani	12514	6257	3	18771
Hasan	Kazasi	12514	6257	13	81341
Arjan	Pulaj	12514	6257	8	50056
Edmond	Xhediku	13000	6500	15	97500
Qemal	Jella	12514	6257	14	87598
Ismet	Sula	12514	6257	5	31285
Feim	Aliaj	12514	6257	16	100112
Bujar	Mema	12514	6257	8	50056
Kujtim	Shefqeti	20000	10000	13	130000
Ylli	Meta	18000	9000	6	54000
Besim	Durishti	20000	10000	23	230000
Sabri	Zylfo	18000	9000	15	135000
Nevruz	Uku	12514	6257	17	106369

Besnik	Katroshi	12514	6257	39	244023
Gëzim	Gazheli	13000	6500	10	65000
Vladimir	Pinderi	20000	10000	24	240000
Totali					10854743

VENDIM
Nr.151, datë 15.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.212, DATË 7.4.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI I RISTRUKTURIMIT TË AEROPORTIT "NËNË TEREZA" SHA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6 e vendimit nr.212, datë 7.4.2005 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.4.2006.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.152, datë 15.3.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FRAKULL TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Frakull të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Frakull të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.422, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën e Frakullës".

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Frakullës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Frakull Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
27-42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
43-57	Varrezat publike	Në pronësi
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
21-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore sportive	Në pronësi
148,152,158,160,161,165	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
149,150,151,153,154,155, 156,157,159,162,163,164, 212,216,226,231,233,235, 237,239,242,246 251,255,256	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
58-69	Prona që përdoren për mbrojtjen civile	Në pronësi
166-189,190-207	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr.153, datë 15.3.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË URA VAJGURORE TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Ura Vajgurore të qarkut të Beratit, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë së Urës Vajgurore, miratuar me vendimin nr.466, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Urës Vajgurore".
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Urës Vajgurore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Ura Vajgurore Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
150-162,187,191,192,197,198 199,201,202,203,204,205 206,207,208,209,210,211, 212,213,214,216,217,218, 219,220	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
4,5,6	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
7-19	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
24-30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
20,23	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
31-39	Pona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
128,135-149,196	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
122-127	Varreza publike	Në pronësi
134,163-186,188,189,190, 215,193,194,195	Troje dhe hapësira	Në përdorim
240,241,242,243,245,246, 247,248,249,250,251,252, 253,254,255,256,257,258,25 9260,261,262,263-272	Toka bujqësore produktive	Në përdorim
244,309,310,311	Toka joproduktive dhe kanale të treta kulluese	Në pronësi
313,316,317,318,319,320, 321,322,323,324,325,326, 329,330,331,336,341,342, 344,347,350,363,364,374,38 7,388,390,393	Pyje kullota	Në pronësi

VENDIM
Nr.154, datë 15.3.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LIBOHOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen

në pronësi ose në përdorim të bashkisë Libohovë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Libohovë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.601, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Libohovës".

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Libohovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Libohovë Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
13,163,165,166	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
8-12	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
1-6,164	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
161-162	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
130	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit tokë bujqësore	Në përdorim
22-26,28,29,31,34,78-81,83,86-88,119,157	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
15-21	Varrezat publike	Në pronësi
27,30,32,33,35-77,82,84-85,89-124	Troje dhe hapësira	Në përdorim
120	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
160	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
125-129	Pyje kullota	Në pronësi
131,135,138,148	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, kanale të treta dhe tokë jobujqësore	Në pronësi
156	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.155, datë 15.3.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë së Lezhës, miratuar me vendimin nr.439, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Lezhës".

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lezhë Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6,107-113,115-131,133-137,141,142,266	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
24-30,33-37,40	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
11-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
42,45,46	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
143-168	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
72-98,169-208,211-234,251-258	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sipërfaqe të gjelbëruara) dhe shërbime publike	Në pronësi
99-102	Varreza publike	Në pronësi
69-71	Troje dhe hapësira	Në përdorim
103-105	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
5,260/2,261/3-261/6,261/9-261/16,262-262/8,262/10-262/12,262/15,262/16,264,265	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi

VENDIM
Nr.156, datë 15.3.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE "JUSTINIANI I"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1,12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Justiniani I".

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Justiniani I”, me seli qendrore në Tiranë (rruga “Hajdar Hidi”), do të ketë vetëm Fakultetin e Drejtësisë (4 vite akademike) dhe në mbarim do të japë diplomën universitare “Jurist”.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.5, datë 20.3.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 24.01.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.51/10 Akti që i përket:

KËRKUESI: AGIM ÇARÇIU, përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: BASHKIA GRAMSH, përfaqësuar nga Flutura Çekrezi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.738, datë 28.04.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, për këto shkaqe:

- Duke pushuar gjykimin për mungesë legjitimimi, Gjykata i ka mohuar të drejtën kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme;
- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë atributet e një gjykate fakti, sepse është marrë me analizën e provave të paraqitura dhe të administruara në gjykatën e rrethit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Bashkisë së qytetit Gramsh, ka marrë vendimin nr.58, datë 6.03.2003, me anën e të cilit është bërë ndarja e apartamenteve të banimit në një pallat, i cili është financuar nga Këshilli i

Ministrave për sistemimin e familjeve, banesat e të cilëve përmbyteshin nga pellgu ujëmbledhës i hidrocentralit të Banjës.

Është vërtetuar se në këtë godinë, ende të papërfunduar e të pa marrë në dorëzim, janë zënë apartamentet si nga familje të shpërngulura nga përmbytja, ashtu dhe familje të tjera të pastreha, duke përfshirë edhe kërkuesin.

Këshilli i Bashkisë, në vendimin e atakuar, nuk parashikoi dhënien e apartamentit për banim kërkuesit, por ia jep një personi tjetër. Në pallat, sipas vendimit, janë sistemuar një numër familjesh që kishin zënë banesat qysh para marrjes së vendimit (ashtu si dhe kërkuesi), një pjesë e të cilëve nuk ishin të shpërngulur me rastin e përmbytjeve.

Ndaj një vendimi të tillë, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila me vendimin nr.1014, datë 24.06.2003, e ka pranuar padinë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.490, datë 4.11.2003.

Në këto vendime është pranuar fakti se kërkuesi si i shpërngulur nga fshati Drizë, duhej të përfitonte banesë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.470, datë 1.07.1998 dhe se Këshilli Bashkiak nuk mund ta ndryshonte destinacionin e këtij pallati duke strehuar në këtë pallat familje që nuk ishin të shpërngulura nga përmbytjet.

Kundër këtyre vendimeve, bashkia Gramsh, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr.738, datë 28.04.2005, ka prishur vendimet e të dy gjykatave dhe e ka pushuar gjykimin e çështjes.

Në mënyrë të përmbledhur në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë përqendrohet rreth faktit se Agim Çarçiu ka hyrë në banesë në mënyrë të kundërligjshme e për pasojë, ai nuk legjitimohet të kundërshtojë në gjykatë aktin administrativ, mbi bazën e të cilit kërkohet të vendosen marrëdhënie ligjore të drejta.

Ndonëse në formë, pretendimet e kërkuesit para Gjykatës Kushtetuese, lidhen drejtpërsëdrejti me dispozita përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me legjitimimin e personave në ngritjen e padisë, ato janë objekt i kontrollit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese, sepse lidhen ngushtësisht me cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkuesit për akses në gjykatë.

Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese vëren se vendimi nr.738, datë 28.04.2005 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është antikushtetues, sepse është rrjedhojë e një procesi të parregullt gjyqësor, duke cenuar nenin 42 të Kushtetutës.

Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë, duke u mbështetur në nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile, pranon mungesën e legjitimimit të kërkuesit në ngritjen e kërkesës, sepse sipas saj, dispozita e mësipërme legjitimimin e lidh me kërkimet e ligjshme.

Në radhë të parë, neni 42/2 i Kushtetutës e përcakton si një të drejtë themelore të qytetarëve që për mbrojtje të të drejtave, lirive e interesave të tyre ligjore e kushtetuese t'i drejtohen gjykatës. Në përputhje me këtë, Kodi i Procedurës Civile, në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në atë të posaçme, zbërthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë çka garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 Kodi e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e në ligje ose jo, kurse neni 32 shkronja "a" parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.

Duke i marrë të lidhura dispozitat e mësipërme, neni 32 shkronja "a" e Kodit, nuk mund kurrësesi të interpretohet ashtu siç ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë që të drejtën dhe interesin e ligjshëm e ka parë të lidhur jo me pretendimin e kërkuesit, por me gjendjen e faktit. Një interpretim e zbatim në çështjen objekt shqyrtimi i nenit 32, të çon në përfundimin e gabuar se pretendimet e personit apriori duhet të jenë gjithmonë të drejta e të bazuara që ai të ketë të drejtë të bëjë padi. Në këtë arsyetim të Gjykatës së Lartë, shihet qartë se konfondohet e drejta subjektive me interesin e ligjshëm, kërkesa këto që dallojnë shqyrtimin e konflikteve juridike civile nga konfliktet administrative siç është ai në shqyrtim.

Për më tej, referimi që bën Gjykata e Lartë te neni 32 i Kodit të Procedurës Civile, nuk është i bazuar. Në titullin e III-të "Gjykime të posaçme", në nenin 323 të këtij Kodi, parashikohet se dispozitat e pjesës së parë e të dytë të tij, janë të zbatueshme edhe për gjykimet e posaçme, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë titull dhe në titullin e IV-t.

Referuar kuptimit të përmbajtjes së dispozitave të këtij titulli e veçanërisht të kreut të II-të "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative" del se përsa i përket së drejtës për të ngritur padi (legjitimimi), si dhe rastet përjashtimore të kompetencës e të legjitimimit janë trajtuar në këtë kre, e në

kushte përgjithësisht ndryshe nga pjesa e përgjithshme, e për pasojë, në rastin konkret, në gjykimin e mosmarrëveshjes administrative do të zbatohen këto rregulla.

Duke iu referuar nenit 325 vihet re se Kodi i Procedurës Civile, padinë e lidh me argumentimin që personi i bën paligjshmërisë së aktit dhe cenimit të interesave e të drejtave të tij në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Siç shihet nga vetë përmbajtja, del i shprehur qartë fakti se Kodi, ka dashur të bëjë dallime midis gjykimit të mosmarrëveshjeve civile të zakonshme e mosmarrëveshjeve administrative. Dhënia e drejtësisë në fushën civile ushtrohet për mbrojtjen e çdo të drejte subjektive, kurse juridiksioni administrativ merret me mbrojtjen juridike të interesave të ligjshme të qytetarit, të cenuara nga një akt i paligjshëm i administratës shtetërore.

Për më tej, lidhur me mosmarrëveshjet administrative, Kodi, në nenin 326, ka parashikuar se kur nuk mund të ngrenë padi në gjykatë. Në interpretim *a contrario* të dispozitës, duke marrë dhe rastin në shqyrtim, del se për goditjen e vendimit nr.58, datë 6.03.2003 të bashkisë Gramsh, si akt administrativ, nuk ka ndalim.

Në një sërë vendimesh të saj, Gjykata Kushtetuese ka pohuar se interpretimi e zbatimi i ligjeve në sferën gjyqësore është e drejtë thelbësore e vetë gjykatave. Megjithatë, kur nga interpretimi apo zbatimi i tyre cenohen drejtpërsëdrejti të drejtat themelore të qytetarëve, ato përbëjnë objekt shqyrtimi nga ajo. Në këto raste, interpretimi i ligjeve materiale e procedurale pa spostuar të drejtën e gjykatave, i shërben Gjykatës Kushtetuese si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e metodës së kontrollit kushtetues.

Duke arsyetuar lidhur me antikushtetutshmërinë në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mungesën e legjitimimit në ngritjen e padisë, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta lërë jashtë shqyrtimit edhe pretendimin e kërkuesit se Gjykata e Lartë ka marrë atributet e një gjykate fakti. Nga shqyrtimi ka dalë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë prova dhe se vendimin e saj e ka mbështetur te provat që janë administruar nga gjykatat e zakonshme e për këtë arsye, këtë pretendim Gjykata Kushtetuese e gjen të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.738, datë 28.04.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

1. **REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
2. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
3. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1.	PROKURIMIN PUBLIK…….	1500
2.	NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) …….	600
3.	SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vellimi i II-të).....	1500
4.	TAKSAT DHE TATIMET…(suplement 2006)…….....	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT……	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT……	2000

DOLI NGA SHTYPI:

1.	PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……	500
2.	KODI DOGANOR…….....	1000
3.	KODI DETAR ……	1000

Doli nga shtypi më 21.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Mësonjëtorja”
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë